REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 136/22
Datë/Datum. 16.05.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.136/ 22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenit 4 i "Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave", si dhe nenit 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE N.T.P "Sankos" sh.p.k me seli në Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim uniforma dhe mjete mbrojtëse në punë", me numër te prokurimit: "KRMC-22-1320-1-2-1", të iniciuar nga AK –"Kompania Regjionale e Mbeturinave–Çabrati" sh.a, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 16 maj 2022, mori këtë:

VENDIM

I. **Hedhet si e paafatshme** ankesa e OE N.T.P "Sankos" sh.p.k me seli në Kaçanik, me nr. të protokollit 136/22, e datës 10.05.20212, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim uniforma dhe mjete mbrojtëse në punë", me numër te prokurimit: "KRMC-22-1320-1-2-1", të iniciuar nga AK –"Kompania Regjionale e Mbeturinave–Çabrati" sh.a.

II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – "Kompania Regjionale e Mbeturinave–

Çabrati" sh.a, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim uniforma dhe mjete mbrojtëse në punë", me numër te prokurimit: "KRMC-22-1320-1-2-1".

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 15.05.2022, ka pranuar ankesë nga OE N.T.P "Sankos" sh.p.k me seli në Kaçanik. Ankesa ndërlidhet me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim uniforma dhe mjete mbrojtëse në punë" ,me numër te prokurimit: "KRMC-22-1320-1-2-1", të iniciuar nga AK –"Kompania Regjionale e Mbeturinave–Çabrati" sh.a.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, sqaron se për aktivitetin e prokurimit në fjalë AK me datën 21.04.2022, ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

OE ankues ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datën 26.04.2022 në ora 21:53h. Autoriteti Kontraktues përgjigjet në lidhje pretendimet e OE ankues me vendimin e datës 29.04.2022, dhe e refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pabazë.

Pas verifikimit në e-prokurim konstatohet se Kërkesa për Rishqyrtim është parashtruar me datën 26.04.2022 në ora 21:53h jashtë orarit të punës (ora16:00), e që numërohet si data 27.04.2022, dita e gjashtë kalendarike.

Sipas nenit 108/ A pika 3. 2 të LPP-së si dhe nenit 4.1(b) të Rregullave të paraqitjes së Kërkesës

për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave përcakton se parashtrimi i Kërkesës për Rishqyrtim parashtrohet si në vijim:

b) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej* ***pesë (5) ditëve*** *pas* ***datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.***

Për më tepër, Neni 109 i LPP-së parasheh se *"Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji."*

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE N.T.P "Sankos" sh.p.k me seli në Kaçanik, hedhet si e pa paafatshme, andaj e njëjta nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – KRM "Cabrati" sh. a
1x1 OE- "Sankos"
1x1 Arhivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së